

2007

Për një mjedis shkollor të lirë nga droga

Projekt propozim

Parandalimi dhe lufta kundër përdorimit të drogës në shkolla



Qendra Studimore e Luftës Kundër Terrorizmit dhe Krimin të Organizuar

Shkolla nuk mund të riparojë të gjitha të këqijat e shoqërisë. Ajo ka përdorim të riparojë vetëm një: të keqen e injorancës.

Ne, si të rritur kemi përgjegjësi, që këto të këqija, t'i përballojmë së bashku me shkollën, mësuesit, komunitetet dhe tërë shoqërinë shqiptare.

ABSTRAKT

Ne e vlerësojmë të një rëndësie të veçantë nisjen dhe nxitjen e veprimtarisë për parandalimin dhe luftën kundër përdorimit të drogës. Droga dhe përdorimi i saj nga moshat e reja, veçanërisht nga grupmosha shkollare është dhe mbetet një nga problemet e madha sociale dhe njëkohësisht e lidhur ngushtë me problemet e mëdha social-ekonomike të kohës së sotme dhe të ardhmen e shoqërisë shqiptare. Prej kohësh janë ndërmarrë një sërë nisma e projekte për përballimin e këtij problem, por përvoja e deritanishme dhe evidencat tregojnë që këto përpjekje nuk kanë dhënë rezultatet që priteshin.

Ka një sërë arsyesh: ka mungesë të dhënash dhe kërkimesh mbi të cilat do të ndërtoheshin veprime, strategji dhe politika efektive; të dhënat dhe informacionet nuk janë analizuar dhe marrë sa duhet në konsideratë nga; ende nuk ka modele ose përafrime të përshtatshme për të ndihmuar nivelet vendimmarrëse për të vendosur dhe caktuar masa efektive për trajtimin e përdorimit të drogës dhe veçanërisht të atyre të moshës së mesme shkollare; periudha e gjatë e tranzicionit, vështirësitë social-ekonomike dhe krizat e identitetit rrisin në frekuencën e gjetjes së rrugëdaljeve tek përdorimi i drogave; pozicionimi i vendit tone në rrugët ndërkombëtare të trafikut të drogës dhe nevoja e marrjes së masave për të penguar dhe luftuar këtë trafik, ka çuar në tërheqjen e vëmendjes nga përdoruesit e brendshëm dhe shpërndarja e drogave midis rinisë shkollare.

Duke u bazuar në misionin, objektivat dhe kualifikimet e anëtarëve të Qendrës Shqiptare të Studimit të Luftës Kundër Terrorizmit dhe Krimit të Organizuar, i kemi resurset njerëzore, aftësitë dhe kualitetet e nevojshme për të arritur me sukses qëllimin dhe objektivat e këtij projekti, duke dhënë kontributin tonë në minimizimin dhe eliminimin e një shqetësimi të tillë.

Ne besojmë se ky është një objektiv i arritshëm nëse bashkohen forcat, gjenden mjetet e nevojshme dhe forcat e profesionalizuara për zgjidhjen e këtij problemi delikat e të vështirë. Harxhimi i forcave, mjeteve dhe përpjekjeve në këtë fushë është me rëndësi, sepse ka të bëjë me kujdesin e shoqërisë për të ardhmen e saj, dhe është i lidhur ngushtë me problemet e sotme social-ekonomike dhe me përpjekjet për të parandaluar një nga shkaqet e përhapjes së krimit të organizuar.

Qëllimi i këtij projekti është të ofrojë nxitje dhe veprimtari të vlefshme për krijimin e nismave dhe politikave efektive, ide dhe aksione konkrete për të mundësuar një reagim të integruar të shtetit, shoqërisë civile dhe komunitetit ndaj përdorimit dhe shpërndarjes së drogës në nxënësit e shkollave.

Objektivi është që ta adresojë këtë veprim në mënyrë efektive dhe dinamike në katër fushat bazë të përballimit të problemit, në zbatimin e ligjit, parandalimin, trajtimin e zvogëlimin e dëmit dhe edukimin.

PËRMBLEDHJE

Edhe pse nuk ka ende studime dhe kërkime sistematike rreth toksikomanisë në Shqipëri, nga përvoja e deritanishme duket se fenomeni përbën një emergjencë dhe numri i të rinjve toksikomanë (sipas të dhënave të UNICEF-it – janar 2002 –) në Shqipëri është rreth 30-40.000 veta, nga të cilët 10.000 vetëm në Tiranë. Për t'iu përgjigjur shumëllojshmërisë së nevojave, është e domosdoshme të shtohen shërbimet të cilat duhet të jenë të shumëllojshme dhe të dobishme, ndërvepruese për të dhënë mesazhe të njëzëshme, që të lejojnë për përdoruesit kalime pa rrezik momentesh braktisjeje apo “zona hijeje” dhe të arrijnë në të gjithë territorin për të mos lënë boshllëqe të rrezikshme. Një kompleksitet i tillë duhet të jetë në rregull nga ana institucionale, i diskutuar dhe i pranuar jo vetëm prej operatorëve pjesëmarrës por nga një opinion publik që duhet të sensibilizohet. Është e rëndësishme të veprohet me trupat mësimore, me familjet dhe vetë të rinjtë, të cilët shpesh duken krejt të papërgatitur dhe të keqinformuara, duke nënvizuar rëndësinë e pjesëmarrjes së integruar të tyre kundër çdo forme viktimizimi, pafuqie apo të zgjidhjeve të thjeshta.

Shqipëria është një vend ku prodhohet, përdoret dhe trafikohet drogë, e si rrjedhojë numri i përdoruesve rritet dita-ditës. Te ardhurat e mëdha që sigurohen, kanë nxitur zonat rurale në kultivimin e “Cannabis sativa”. Grupmoshat më të ekspozuara ndaj drogave janë ato 16-28 vjeç. (Për femrat grupmosha 16-21 vjeç dhe meshkujt 17-28 vjeç). Në disa Raporte të botuara online, argumentohet se mosha e fillimit të përdorimit të drogës është 13-14 vjeç, dhe shumica e tyre kanë një histori 8-10 vjeçare të përdorimit të disa syresh. Fillimisht ata kanë përdorur droga të ashtuquajtura të lehta, për të kaluar më tej në droga të “rënda” si heroina, dhe shumë prej tyre tashmë e injektojnë heroinën. Shumica e përdoruesve përdorin kanabis, por ka një rritje të personave që janë të varur nga heroina. Problemi i përdorimit të drogës në grupmoshat e reja ka një shtrirje gjeografike në mbarë vendin, por

